



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 21.4.1-2017-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË
ARSIMIT SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017

Prishtinë, qershor 2018

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në konsultim me Ndihmës Auditoren e Përgjithshëm Emine Fazliu, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Mehmet Muçaj (udhëheqës i ekipit), Natyra Kasumaj dhe Muharrem Qyqalla (anëtarë ekipi), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Florim Beqiri.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	11
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	23
5 Qeverisja e mirë.....	24
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	28
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme	31
Shtojca III: Komentet e ministrit në gjetjet e raportit të auditimit	35
Shtojca IV: Letër konfirmimi	40

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 10.10.2017.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson Menaxhmentin e lartë dhe stafin e Ministrisë, për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me Theksim të çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017, paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

Theksim i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj në faktin se vlera e pasurive fikse, e shpalosur në PFV ishte e mbivlerësuar. Kjo ka ndodhur si pasojë e mos bartjes së pronësisë së shkollave të komunat dhe e regjistrimit të librave në regjistrin e pasurive kapitale. Më tutje, blerja e librave ishte buxhetuar dhe realizuar gabimisht nga kategoria investime kapitale. Po ashtu salldo e detyrimeve kontingjente ishte nënvlerësuar.

Për më gjerësisht shih pjesën 2.1 të këtij raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore

Opinion i pamodifikuar me Theksim të Çështjes pasqyron dobësitë në kontrolle për ta konfirmuar vlerësimin e duhur të pasurisë, klasifikimin e duhur të shpenzimeve dhe saldove të detyrimeve kontingjente.



Ministri duhet t'i analizojë arsyet për Theksimin të Çështjes në 2017 dhe t'i identifikojë veprimet që kërkohen për të mundësuar një prezantim të drejtë dhe të vërtetë të vlerave në vitin 2018. (shih kapitullin 2.1)

Procesi i përgatitjes së PFV-ve është menaxhuar dobët, me disa gabime financiare, keqklasifikim dhe shpalesje jo të plotë të pasurive.



Ministri duhet të sigurohet se procesi i përgatitjes së PFV 2018 përfshinë një rishikim menaxherial formal dhe efektiv dhe deklarata për PFV-të të nënshkruhet vetëm pasi janë zbatuar të gjitha veprimet e nevojshme (shih kapitullin 2.1 dhe 2.2)

Planifikimi i buxhetit për kategorit paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime dhe investime kapitale është sfid me të cilën po ballafaqohet ministria.



Ministri duhet të aplikojë një vlerësim të detajuar të fushave brengosëse të theksuara në këtë Raport për t'i identifikuar arsyet për paraqitjen e dobësive si dhe të përcaktoj veprimet e nevojshme për t'i adresuar ato (shih çështjet 2).

Edhe pse kontrollet e brendshme kanë operuar në mënyrë efektive në disa fusha, dobësi evidente janë vërejtur në disa sisteme të rëndësishme financiare, duke përfshirë të hyrat, pagat, mallrat dhe shërbime dhe investimet kapitale.



Ministri duhet ta aplikojë një vlerësim të detajuar të menaxhimit të investimeve, mallrave dhe pagave si dhe fushave tjera brengosëse të theksuara në këtë raport për t'i identifikuar arsyet për paraqitjen e dobësive si dhe veprimet e nevojshme për t'i adresuar ato (shih çështjet 3-16).

Përgjigja ndaj rekomandimeve të vitit paraprak nuk po adresohen ashtu siç kërkohet për zhvillimin dhe përmirësimin e organizatës.



Ministri duhet ta zbatoj një proces rigoroz për të siguruar që procesi i rekomandimeve të viteve paraprake adresohen dhe monitorohen në mënyrë aktive (shih çështjet 17)

Aranzhimet e qeverisjes që kanë të bëjnë me llogaridhënien, dhe raportimin menaxherial janë të dobëta. Aktiviteti i Auditimit të Brendshëm nuk i mbështetë zhvillimet në këtë fushë.



Ministri duhet të sigurojë që aranzhimet e Qeverisjes janë rishikuar në mënyrë kritike për t'u siguruar se janë bërë ndryshime adekuate në përmirësimin e aranzhimeve të llogaridhënies dhe raportimit menaxherial për ta ngritur efektivitetin operativ të mbështetur nga një NJAB më efektive (shih çështjet 17 dhe 18).

Përgjigja e Ministrit – auditimit 2017

Ministri ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me pjesën më të madhe të të gjeturave të detajuara dhe konkluzionet e auditimit. Komentet për të cilat janë pajtuar pjesërisht apo nuk janë pajtuar mund t'i gjeni në shtojcën III.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e ministrisë. Ne kemi analizuar veprimtarinë e ministrisë se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e AP-së.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Përgjigjet e Ministrit ndaj gjetjeve tona mund të gjenden në Shtojcën III.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, nr.01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Duam të tërheqim vëmendjen tuaj në faktin se:

- Pasuritë kapitale janë të mbivlerësuara për 3,058,150€. Kjo ka ndodhë për faktin që shkollat e ndërtuara nga MASHT, pas finalizimit nuk ishin transferuar te komunat që janë edhe pronarë të atyre shkollave;
- Ligji nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës obligon MASHT-in që të ofrojë falas tekstet shkollore për nxënësit e nivelin I dhe II të arsimit parauniversitar. Bazuar në këtë, MASHT në vitin 2017, kishte buxhetuar dhe shpenzuar 3,218,249€. Mjetet për këto tekste ishin trajtuar gabimisht si investime kapitale në vend se të trajtohen si subvencione dhe transfere, edhe përkundër kërkesave të MASHT-it drejtuar MF-së, që këto mjete të mos trajtohen si investime kapitale. Këto shpenzime ishin regjistruar në regjistrin e pasurive duke mbivlerësuar vlerën e pasurive të shpalosur në PFV. Përveç kësaj ishin bërë keqklasifikime të planifikuara dhe të realizuar nga kategoria investime kapitale (190,992€), për mallra dhe shërbime; si dhe
- Saldo përfundimtare e detyrimeve kontingjente në vitin 2016 ishte e nënvlerësuar për 239,353€, për shkak se këto detyrime MASHT nuk i kishte përfshirë në PFV e vitit 2016.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Ministri është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbuloj çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Nga MASht kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullat Financiare nr.01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK).
- Raporte tre mujore duke përfshirë edhe pasqyrat financiare nëntë mujore;
- Raportimet për obligimet e papaguara; dhe
- Planifikimin e prokurimit dhe raportin e kontratave të nënshkruara.

Edhe pse PFV ishin korrigjuar (10.04.2018) ato ende përmbajnë disa gabime. Përveç gabimeve të cilat kanë ndikuar në theksim të çështjes të opinionit të auditimit, donacionet nuk ishin prezantuar saktë në PFV:

- Te neni 14 - Raporti i Ekzekutimit të Buxhetit të hyrja e parasë së gatshme në shtyllën e buxhetit final grantet e përcaktuar të donatorëve ishin mbivlerësuar për 132,442€ (vlera e prezantuar ishte 365,436€, përderisa vlera e duhur ishte 232,994€).

Të gjeturat më lartë, tregojnë që përgatitja e PFV-ve është menaxhuar në mënyrë të dobët.

DEKLARATA E BËRË NGA MENAXHMENTI

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, është e saktë, përveç çështjeve të përmendura më lartë.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

- Rekomandimi 1** Ministri duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes. Duhet të ndërmerren veprime konkrete lidhur me bartjen e pronësisë për shkollat e ndërtuara nga MASHT te komunat përkatëse dhe se këto pasuri duhet të largohen nga regjistri i pasurive të ministrisë.
- Rekomandimi 2** Ministri duhet të iniciojë rishikimin e Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës nr.04/L-032 dhe të udhëzimit administrativ nr.13/2016, me qëllim të shmangies së paqartësive për furnizim me tekste shkollore. Si dhe të mbajë në konsideratë, që projektet që për nga natyra i takojnë mallrave dhe shërbimeve të mos planifikohen në kategorinë e investimeve kapitale.
- Rekomandimi 3** Ministri të sigurojë se bëhet prezantimi i plotë dhe i saktë i detyrimeve kontingjente. Dhe se deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj PFV-ve janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në MASHT. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat në përgjithësi janë të përshtatshme dhe janë duke u zbatuar, por se kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për të parandaluar shpenzimet jo racionale. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë planifikimi i buxhetit, regjistrimi i pasurive kapitale, klasifikimi i duhur i shpenzimeve, shpalesje e plotë e detyrimeve kontingjente, raportim i drejt i obligimeve të paguara dhe menaxhimi i personelit.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, shpenzimet e fondeve si dhe të hyrat e arkëtuara sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Burimet e Fondeve:	47,287,848	45,379,772	41,528,363	47,892,635	42,800,007
Granti i Qeverisë -Buxheti	42,771,500	40,616,924	39,295,443	44,228,978	38,954,016
Financimi nga huamarrja	2,647,400	1,697,400	384,861	1,543,000	958,600
Të bartura nga viti paraprak ² -	-	831,063	681,354	507,121	397,468
Të hyrat vetjake ³	1,868,948	1,868,948	1,032,422	946,897	1,282,535
Donacionet e jashtme	-	365,437	134,283	666,639	1,207,388

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 1,908,076€. Zvogëlimi i buxhetit kishte të bënte 950,000€ nga huamarrja ndërsa zvogëlimi tjetër është bërë me përshtatje buxhetore. Zvogëlimi në buxhetin e huamarrjes ishte bërë për arsye se disa projekte kapitale që kanë qenë të planifikuara të realizohen nga huamarrja nuk ishin realizuar.

Në vitin 2017, MASHT ka shpenzuar 91.5% të buxhetit final ose 41,528,363€, me një rënie prej 4.5% krahasuar me vitin 2016.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	47,287,848	45,379,772	41,528,363	47,892,635	42,800,007
Pagat dhe Mëditjet	15,931,068	17,123,188	16,958,240	15,925,257	13,314,071
Mallrat dhe Shërbimet	9,302,672	10,405,674	8,421,900	8,294,192	8,851,988
Shërbimet komunale	1,245,259	1,420,400	1,022,455	935,411	991,042
Subvencionet dhe Transfere	3,821,929	4,364,049	4,079,161	3,374,488	3,918,128
Investimet Kapitale	16,986,920	12,066,461	11,046,607	19,363,287	15,724,778

¹ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

² Të hyrat vetjake të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

³ Të hyrat vetjake të buxhetuara për shpenzim.

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Buxheti final krahasuar me buxhetin fillestar për paga dhe mëditje ishte rritur për 1,192,120€. Rritja ishte bërë me rishikim të buxhetit, si dhe me vendime të Qeverisë për përshtatjen e buxhetit të MASHT-it. Kjo ishte rezultat i planifikimit jo të mirë të buxhetit për këtë kategori;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte rritur për 1,103,002€, nga kjo vlerë 498,800€ ishte nga rishikimi i buxhetit, ndërsa pjesa tjetër me vendime të Qeverisë. Edhe përkundër rritjes, buxheti i shpenzuar i kësaj kategorie ishte në nivel jo të kënaqshëm (81%);
- Buxheti final krahasuar me atë fillestar për shërbime komunale ishte rritur për 175,141€, ndërsa ishte shpenzuar në nivel 72%. Në këtë rritje kanë ndikuar ndarjet e mjeteve në vlerë 51,200€ me rishikim të buxhetit, nga të hyrat vetjake të bartura 156,892€ si dhe me vendim të Qeverisë nr. 13/16 të datës 15.12.2017 ishte një zvogëlim i buxhetit për 32,951€;
- Buxheti final krahasuar me atë fillestar për subvencione ishte rritur për 542,120€. Kjo ka ndodhur si rezultat i rishikimit të buxhetit, si dhe vendimeve të Qeverisë për përshtatjen e buxhetit të MASHT-it; dhe
- Buxheti final për investimet kapitale ishte zvogëluar për 4,920,459€. Kjo ka ndodhur si rezultat i rishikimit të buxhetit, si dhe vendimeve të Qeverisë për përshtatjen e buxhetit të MASHT-it.

Çështja 4 – Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

E gjetura	MASHT nuk kishte bërë planifikim të mirë të buxhetit pasiqë, për gjatë vitit janë bërë shumë ri-përshtatje nëpër kategori ekonomike. Më tutje, kishte bërë planifikim jo të mirë të buxhetit sidomos te kategoria e investimeve kapitale duke vendosur projekte të cilat për nga natyra i përkasin kategorisë mallra dhe shërbime.
Rreziku	Nevojat e shumta për përshtatje, janë tregues që përgatitja e buxhetit nuk është bazuar në nevojat reale të MASHT-it për realizimin e tij. Planifikimi jo i mirë i buxhetit për kategoritë përkatëse rrezikon ministrinë në arritjen e objektivave të caktuara.
Rekomandimi 4	Ministri duhet të siguroj se bëhen analiza të mirëfillta ndaj kërkesave buxhetore për kategoritë ekonomike në mënyrë që përshtatjet buxhetore të jenë sa më të vogla, duke mos rrezikuar arritjen e objektivave të planifikuara.

3.2 Të hyrat

MAShT sipas regjistrave të brendshëm për vitin 2017 kishte planifikuar të inkasoj të hyra në vlerë 3,321,961€, ndërsa kishte realizuar 3,125,718€. Në vitin 2017 MAShT-it i ishin lejuara për shpenzim 1,868,948€, ndërsa nga të hyrat i kishte shpenzuar 1,713,776€. Të hyrat mbledhen nga participimi i studenteve, akreditimi i programeve akademike, qiraja etj. Në tabelën më poshtë shihet realizimi i të hyrave nëpër vite:

Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar ⁴	Buxheti Final	2017 Pranimet	2016 Pranimet	2015 Pranimet
Të hyrat vetjake	1,868,948	1,868,948	3,125,718	3,222,790	3,187,905

Nga tabela shohin se përgjatë viteve kemi pothuajse një trend të njejtë në inkasimin e të hyrave.

Çështja 5 - Regjistrimi i të hyrave jo në kode adekuate

E gjetura Të hyrat e mbledhura nga Agjencioni Kosovar i Akreditimit nuk ishin regjistruar ashtu siç e parasheh plani kontabël i nxjerr nga thesari. Ato ishin regjistruar në kodin ekonomik 50401 si shitje e shërbimeve, ndërsa duhet të regjistrohen në kodin 50415 tarifa për akreditim. Po ashtu, kthimi i të hyrave nga participimi i studenteve nuk ishin regjistruar në kodin adekuat 50410 si kthim nga participimet por në kodin ekonomik 50409 si participimet.

Rreziku Regjistrimi i të hyrave në kode jo adekuate nuk ofron një pasqyrim të qartë për llojin e të hyrave, dhe se kjo ndikon në krahasimin e realizimit me planifikim të të hyrave nëpër kodet përkatëse.

Rekomandimi 5 Ministri duhet të siguroj kontrolle shtesë që regjistrimi i të hyrave vetanake bëhet në kode adekuate siç parashihet me planin kontabël.

3.3 Pagat dhe shtesat

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga MAP dhe MF. Buxheti final për paga dhe mëditje ishte 17,123,188€, ndërsa shpenzimi 16,958,240€. Ne testuam pajtueshmërinë e listave të pagave me sistemin e payrollit, (punëtorët aktual, rekrutimet, largimet, dhe pushimet e lehonave, pensionet). Po ashtu, kemi rishikuar nëse punonjësit janë paguar sipas kontratës.

⁴ Në këtë tabelë buxheti fillestar dhe final prezanton buxhetimin për shpenzim e jo për inkasim.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.4 Menaxhimi i personelit

Menaxhimi i personelit përfshin të gjitha veprimet që ndërlidhen me rekrutimin, mbulimin e pozitave me UD, kontratat, trajnimet, avancimin, pushimet etj. Ne testuam një numër mostrash për të siguruar se veprimet e ndërmarra në këtë fushë janë në harmoni me rregulloret e zbatueshme. Nga testimet e bëra ka rezultuar çështja si në vijim:

Çështja 6 - Pozitat me Ushtrues Detyre

- E gjetura** Ligji për Shërbimin Civil nr.03-L-149, përcakton se një pozitë nuk mund të mbahet nga ushtruesi i detyrës për më shumë se tre (3) muaj.
- Pozita e Sekretarit të Përgjithshëm, zyrtares për shpenzime, zyrtarit certifikues si dhe pozita e drejtorit në departamentin për politika të arsimit para universitar mbahen me ushtrues detyre që nga viti 2015. Më tutje, edhe pozita e udhëheqësit të divizionit të prokurimit mbahet me ushtrues detyre që nga viti 2016. Vlen të theksohet se Sekretari i Përgjithshëm është përzgjedhur në shkurt të vitit 2018.
- Rreziku** Mbulimi i pozitave të rëndësishme me ushtrues detyre për një kohë të gjatë, rrit rrezikun e mos arritjes së objektivave dhe performanca/përgjegjësia e realizuar në këto pozita të mos jetë në nivelin e duhur.
- Rekomandimi 6** Ministri duhet të marrë masa të menjëhershëm që për pozitat të cilat mbulojnë me ushtrues detyre bëhet një zgjidhje e qëndrueshme me pozita të rregullta në pajtim me kërkesat ligjore.

3.5 Mallrat dhe shërbimet si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime dhe komunalni në vitin 2017 ishte 11,826,074€. Prej tyre ishin shpenzuar 9,444,355€. Ato kanë të bëjnë me shpenzimet për furnizime me material zyrtar, furnizim me ushqime, shërbime kontraktuese, shërbime komunale, udhëtime zyrtare, shërbime të mirëmbajtje etj. Nga testimet e bëra kanë rezultuar çështjet në vijim:

Çështja 7 - Mos zhvillimi i procedurave të prokurimit

- E gjetura** Universitetit të Prizrenit (UPz), i kishte skaduar kontrata për "Mirëmbajtja e Sistemit Elektronik të Menaxhimit të Studentëve (SEMS)" me 04.10.2017. Edhe pse ky projekt ishte i paraparë me planin e prokurimit, zyra e prokurimit nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim për të filluar me procedurat e duhura në prokurim në mënyrë që të përzgjidhet ndonjë operator i cili do ta mirëmbante SEMS-in. Situata e njëjtë pothuajse ishte edhe në Universitetin e Gjakovës i cili kishte shfrytëzuar kontratën e UPz për mirëmbajtjen e SEMS-it.
- Rreziku** Neglizhenca e zyrave të prokurimit për të filluar në përzgjedhjen e një operatori për mbikëqyrjen e SEMS, rritë rrezikun e mosfunksionalizimit të këtij sistemi duke bërë çrregullim të informatave në lidhje me kartelën (gjendjen) e studentëve.
- Rekomandimi 7** Ministri duhet të siguroj që procedurat e prokurimit të zhvillohen me kohë për ta zgjedhur operatorin për mirëmbajtje në mënyrë që të shmanget rreziku nga mosfunksionimi i SEMS-it.

Çështja 8 - Mos nënshkrim i deklaratës për disponueshmëri të fondeve nga ZKA dhe ZKF

- E gjetura** Në projektin "Furnizim me tonera" për nevoja të UPz në vlerë 4,717€, vërejtum se deklarata për disponueshmëri të fondeve nuk ishte e nënshkruar nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar. Zyra e prokurimit kishte vazhduar me aktivitetin e prokurimit dhe kishte nënshkruar kontratën.
- Rreziku** Mos nënshkrimi i deklaratës për disponueshmëri të fondeve rritë rrezikun e hyrjes në obligime kontraktuale pa mbulesë të mjaftueshme.
- Rekomandimi 8** Ministri të siguroj që para zhvillimit të procedurave të prokurimit të merr aprovimet nga zyrtarët kyç për disponueshmëri të mjeteve.

Çështja 9 - Mangësi në procedimin e pagesave

- E gjetura** Sipas rregullës nr. 01/2013 për Shpenzimin e Parasë Publike, fillimisht duhet të bëhet kërkesa për blerje, zotimi i mjeteve, procesohet urdhër blerja, pastaj pranohet malli apo shërbimi dhe pas pranimit të faturës të ekzekutohet pagesa.
- Te mallrat dhe shërbimet identifikua se në 19 pagesa, zotimi dhe urdhër blerja ishte bërë pas pranimit të faturës dhe mallit.
- Rreziku** Mos ndjekja e procedurave të duhura të kontrollit gjatë pranimit të mallit dhe kryerjes së pagesave mund të ndikojë, në pranimin e mallrave që nuk janë në pajtim me kushtet e kontraktuara dhe në pagesa potencialisht të parregullta.
- Rekomandimi 9** Ministri duhet të iniciojë një rishikim të brendshëm dhe të ndërmerri masat e duhura për të siguruar që dështimet e ngjashme nuk do të ndodhin në të ardhmen.

Çështja 10 - Projekti Historia e Kosovës

- E gjetura** Projekti “Historia e Kosovës” ishte planifikuar në kategorinë e investimeve kapitale por me rishikim ishte larguar nga kjo kategori. Sipas MASHT-it arsyeja e largimit prej kategorisë së investimeve kapitale ishte pa mundësia e angazhimeve me marrëveshje dhe pagesave të eksperteve hulumtues të kësaj fushe nga kjo kategori, prandaj projekti kishte filluar të realizohet nga kategoria mallra dhe shërbime. Instituti i Historisë (IH) kishte lidhur Marrëveshje Bashkëpunimi për çështje të hulumtimit të Historisë së Kosovës me hulumtues të ndryshëm nga vendi përfshirë edhe ata nga Shqipëria dhe Maqedonia, ku ishin përcaktuar edhe shumat që do të mbulohen në angazhimet e hulumtuesve. Në testimin e pagesës në vlerë 22,500€, identifikua që shpenzimet për disa hulumtues të angazhuar me marrëveshje ishin tejkualuar. Në tri raste shumat e aprovuar në bazë të Marrëveshjeve ishin 9,000€ ndërsa shpenzimet për tri rastet ishin 11,471€.
- Rreziku** Tejkalimi i shpenzimeve të parapara sipas marrëveshjeve është rezultat i mungesës së kontrolleve të brendshme në krahasim me shpenzimet e aprovuara dhe rrit rrezikun e dëmtimit të buxhetit.
- Rekomandimi 10** Ministri duhet të siguroj se marrëveshjet e nënshkruara në mes Institutit të Historisë dhe hulumtuesve për hulumtimin e Historisë së Kosovës do të respektohen në përpikëri duke mos tejkualuar vlerat e tyre.

Çështja 11 - Angazhim i organit mbikëqyrës pa respektuar rregullat dhe udhëzuesin operativ të prokurimit

E gjetura Rregullat dhe udhëzuesi operativ i prokurimit publik i vitit 2016 (neni 61.18) rregullojnë që në raste të angazhimit të organit mbikëqyrës duhet të zhvillohen procedurat prokurimit. Universiteti i Prizrenit kishte angazhuar me kontratë për shërbime të veçanta një organ mbikëqyrës për projektin “Renovimi i konviktit të UPZ-së” në vlerë 370,370€, pa zhvilluar procedurat e prokurimit. Për periudhën gjashtë mujore sipas marrëveshjes organi mbikëqyrës do të kompensohet me 1% të vlerës së kontratës (3,703€).

Rreziku Angazhimet e organit mbikëqyrës pa respektuar procedurat e prokurimit ndikon në kufizimin e konkurrencës si dhe në trajtimin jo të barabartë në mes konkurrentëve.

Rekomandimi 11 Ministri duhet të siguroj që në raste të tilla të aplikohen procedura të prokurimit sipas kërkesave të parapara nga rregullat dhe udhëzuesit operativ të prokurimit.

3.6 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 4,364,049€. Prej tyre ishin shpenzuar 4,079,161€. Kryesisht këto shpenzime kanë të bëjë me pagesat e bëra nga MASHT sipas marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet e ndryshme si: Sheffield-it, USAID, Fulbright, dhe projektin e Loyola-s.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandim për këtë fushë.

3.7 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 12,066,461€, prej tyre ishin shpenzuar 11,046,607€. Këto shpenzime kanë të bëjnë me ndërtimin e disa shkollave, blerjen e librave shkollore, furnizim me inventar shkollor dhe pajisje tjera . Gjatë vitit 2017 fusha e prokurimit ishte përcjell me disa mangësi të cilat po i përshkruajmë më poshtë.

Çështja 12 - Sigurimi i ekzekutimit jo në harmoni me kërkesat ligjore

E gjetura Bazuar në Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për prokurimin publik, pika 30, Siguria e Ekzekutimit është paraparë të mbështetë përmbushjen e kontratës, dhe do të mbetet valid për një periudhë prej 30 ditë pas kompletimit të kontratës. Gjatë testimit të aktiviteteve të prokurimit në tre (3) raste identifikua se sigurimi i ekzekutimit nuk mbulonte kohëzgjatjen e kontratës. Siguria e ekzekutimit ishte e mangët në këto raste:

- Te kontrata “Ndërtimi i shkollës fillore Leshan-Suharekë-faza I” në vlerë 329,639€, siguria e ekzekutimit në momentin e nënshkrimit të kontratës ishte për dy muaj ndërsa kontrata është tri vjeçare;
- Te kontrata “Ndërtimi i shkollës në Busavat-Kamenicë, Lot 1” në vlerë 241,645€, siguria e ekzekutimit ishte për 12 muaj ndërsa kontratë është tri vjeçare; dhe
- Te kontrata “Ndërtimi i shkollës se mesme Adem Gllavica në Lipjan” në vlerë 450,087€, siguria e ekzekutimit ishte për 24 muaj ndërsa kontrata është tri vjeçare.

Rreziku Ofrimi i sigurimit të ekzekutimit të kontratës për periudhë më të shkurtër se sa parashihet me rregulla, pamundëson ndëshkimin eventuale ndaj operatorëve në rastet kur kontrata nuk përmbushet.

Rekomandimi 12 Ministri duhet të siguroj se me rastin e nënshkrimit të kontratave zyra e prokurimit të sigurohet se siguria e ekzekutimit të kontratës e mbulon periudhën e kërkuar të kontratës.

Çështja 13 - Hyrje në obligime kontraktuale më shumë se sa ndarjet buxhetore

E gjetura MASHT kishte nënshkruar kontratë për projektin “Ndërtimi i shkollës fillore në Braboniq- Mitrovicë” në vlerë më të madhe se ndarjet buxhetore. Kontrata ishte në vlerë 1,179,812€, ndërsa ndarja buxhetore e paraparë për tre vite në tabelën e projekteve kapitale ishte 800,000€.

Rreziku Hyrja në obligime kontraktuale në vlera më të larta se sa ndarjet buxhetore rrisin rrezikun që të krijohen obligime të pambuluara si dhe rritjen e pagesave direkte nga Thesarit. Kjo pastaj mund të reflekton edhe në prishjen e balancave buxhetore në projekte tjera kapitale.

Rekomandimi 13 Ministri duhet të siguroj se nuk do të hyj në obligime kontraktuale më shumë se sa ndarjet buxhetore.

Çështja 14 - Llogaritje e gabuar e kontratës

E gjetura Te kontrata “Ndërtimi i çerdheve të fëmijëve, sallave të sportit dhe renovimin e shkollave” loti shtatë, ministria kishte nënshkruar kontratë me vlerë më të lartë se sa vlera e ofertës. Vlera e kontratës ishte 75,656€, ndërsa oferta e OE ishte 74,995€ (kontrata është nënshkruar për 661€ më shumë se oferta financiare e OE).

Rreziku Nënshkrimi i kontratave në vlerë më të lartë se oferta e OE ndikon në dëmtimin e buxhetit të ministrisë.

Rekomandimi 14 Ministri duhet t’i shtoj kontrollet për të siguruar se vlera e kontratave të jetë në përputhje me ofertën financiar të ofruar nga operatori ekonomik. Po ashtu, të rishikohet mundësia e korrigjimit të kontratës duke e harmonizuar me vlerën reale të ofertës financiare.

Çështja 15 - Tejkallim i sasive të kontraktuara

E gjetura Bazuar në Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik neni 61.22 thekson se “Aty ku ndryshohet kontrata me qëllim të ndryshimit të termave dhe kushteve fillestare, ndryshimi i kontratës do të përgatitet nga departamenti i prokurimit”. Ne identifikua rastet si në vijim:

- Në pagesën në vlerë 71,933€ që ndërlidhet me situacionin e parë, për kontratën “Ndërtimi i shkollës fillore Gllloboqicë-Kaçanik” - 266,712€ (e nënshkruar me 19.04.2017), identifikua se në pozicionin 410 për betonim të shtresës së betonit, sasia e kontraktuar në specifikacionin teknik ishte 68.4 m³ ndërsa sasi të faturuar dhe të paguara ishin 142m³ edhe në pozicionin 422 për latimi dhe betonimi i soletës, sasi të kontraktuara ishin 361.55m³, ndërsa sasi të faturuara dhe të paguara ishin 486.6m³. Pra në këto dy pozicione janë tejkalluar sasi të paguara për 198.65m³ dhe shumëzuar me çmimet respektive (70€ dhe 95€) rezulton se kemi tejkallim në vlerë prej 17,031€; dhe
- Në pagesat 11,482€ dhe 19,169€ që ndërlidhen me situacionin e nëntë të kontratës ‘Ndërtimi i sallës së edukatës fizike në shkollën fillore Rexhep Elmazi’ në Gjilan në vlerë 210,823€ (e nënshkruar me 16.05.2017), punët e armimit të pjesa C pozicioni 1 sasia e kontraktuar ishte 25,000kg, me çmim 1.45€, ndërsa sasi të tejkalluara dhe të faturuara (paguara) ishin 9,308.18kg. Tejkallimi i shndërruar në vlerë financiare është 13,496€ (9,308.18kg*1.45€).

Edhe pse kishte ndryshime të sasive nga kontratat fillestare të cilat reflektojnë në çmimin total të kontratës, zyra e prokurimit nuk kishte ndryshuar kontratat (nuk kishte lidhë aneks kontrata për sasi të shtesë).

Rreziku Tejkalimi i sasive në pozicione të caktuara rritë rrezikun që të mos realizohen pozicione të tjera të kontraktuara dhe projektet të mbeten të pa përfunduara.

Rekomandimi 15 Ministri duhet të siguroj se në rastet e tejkalimit të sasive të cilat ndikojnë në çmimin total të kontratës zyra e prokurimit të bëjë ndryshimin e kontratës siç parashihet me rregullat dhe udhëzuesin operativ të prokurimit publik.

3.8 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

MAShT kishte adresuar rekomandimin tonë të dhënë vitin e kaluar, i cili ndërlidhej me bartjen pronësisë së pasurive të investuar nga ministria tek institucionet përkatëse dhe largimin e tyre nga regjistri i pasurive të ministrisë. Gjendja e pasurive mbi 1,000€ në vitin 2016 ishte 259,777,726€, ndërsa në fund vitit 2017, ishte 136,894,093€. Përkundër kësaj regjistri i pasurisë ende përmban disa mangësi të cilat i paraqesim si në vijim:

Çështja 16 – Menaxhim i dobët i regjistrave të pasurive

E gjetura Rregullorja nr. 02/2013 – për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore kërkon që pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale duhet të regjistrohet në sistemin “e-pasuria”.

Ne identifikuam që nëntë programe të MAShT-it nuk e përdorin sistemin e e-pasurisë. Po ashtu, Universiteti i Pejës “Haxhi Zeka” dhe Universiteti i Gjakovës “Fehmi Agani” kishin regjistruar disa pasuri mbi 1,000€, në sistemin e e-pasuria në vend që të regjistrohen në SIMFK.

Rreziku Mos përdorimi i sistemit të e-pasurisë dhe regjistrimet e gabuara pamundësojnë menaxhimin efektiv dhe kontrollin e duhur mbi pasuritë.

Rekomandimi 16 Ministri duhet të siguroj se janë vendosur kontrollet e duhura të cilat mundësojnë që menaxhimi i pasurisë bëhet përmes regjistratit të plotë dhe të saktë të SIMFK-së si dhe të sistemit të e-pasurisë.

3.9 Të arkëtueshmet

Llogaritë e arkëtueshme (LLA) në fund të vitit 2017 ishin 185,310€, dhe krahasuar me vitin paraprakë ato ishin zvogëluar për 83,600€ (2016 - 268,910€). Burimet e LLA janë nga: qiraja, faturimet për akreditim nga Agjencioni Kosovar i Akreditimit.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.10 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2017 ishte 948,433€, dhe se këto obligime janë bartur për tu paguar në vitin 2018.

MAShT gjatë vitit 2017 kishte shpenzuar 313,828€, në bazë të vendimeve gjyqësore dhe 16,760€ ishin ekzekutuar nga Thesari (MF) në bazë të nenit 39.2 të LMFPP. Po ashtu në PFV 2017, ishin shpalosur 797,350€ detyrime kontingjente.

Çështja 17 - Rritje e obligimeve dhe raportim jo i drejtë i obligimeve të pa paguara

E gjetura Obligimet e papaguara në vitin 2017 krahasuar me vitin e kaluar ishin rritur për 354,673€ (2016 - 593,760€). Kjo rritje kishte ndodhur për shkak se nuk ishin menaxhuar dhe paguar me kohë obligimet.

Po ashtu, vlera e obligimeve të raportuar nga MAShT në PFV 2017 nuk ishin të sakta për shkak se:

- Faturat në vlerë prej 7,860€, ishin obligime që i takojnë vitit 2018; dhe
- Në PFV ishin raportuar 8,480€ si obligime të vitit 2015, përderisa të njëjta nuk ishin shpalosur në PFV e vitit 2016.

Rreziku Shumat e raportuara të obligimeve të pa paguara janë shuma domethënëse për buxhetin e ministrisë dhe si të tilla, mund të ndikoj në balancat buxhetore.

Rekomandimi 17 Ministri duhet t'i jap prioritet shlyerjes së obligimeve të vitit 2017, për shkak se ministria mund të paditet nga operatorët ekonomik, po ashtu duhet të siguroj regjistrim të saktë të obligimeve.

Çështja 18 - Pagesa sipas vendimit gjyqësor

E gjetura MAShT kishte humbur kontestin gjyqësorë me Kolegjin AAB dhe si rezultat i humbjes sipas vendimit gjyqësor kishte paguar 239,353€. Kjo humbje e kontestit gjyqësor ka ndodhur për shkak se neni⁵ 23 i Udhëzimit Administrativ mbi akreditimin i hartuar nga ministria ishte në kundërshtim me ligjin për arsimin e lartë nr. 04/L--037.

Rreziku Ekzekutimi i pagesave të tilla mund të ndikon në prishjen e ekuilibrit buxhetor dhe rritë rrezikun që projektet e planifikuara me projeksionet fillestare të mos realizohen fare.

Rekomandimi 18 Për t'iu shmangur situatave të ngjashme, Ministri duhet të siguroj që legjislacioni sekondar të jetë në harmoni me ligjet dhe të forcoj disiplinën financiare që të gjitha obligimet të paguhen me kohë.

⁵ Institucionet private të akredituara do t'ia paguajnë Agjencionit Kosovar të Akreditimit një shumë fikse prej 5€ për student në vit si tarifë tatimore për akreditim.

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2016 për MASHT-in ka rezultuar në 21 rekomandime. MASHT kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna. Po ashtu, raporti ynë i auditimit për PFV e MASHT për vitin 2016, është diskutuar nga Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike me 23.03.2018, më që rast komisioni ka dal me disa rekomandime për MASHT, të cilat pritet t'i adresoj ministria.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2017, nëntë rekomandime janë zbatuar, tri ishin në proces dhe nëntë nuk janë adresuar ende. Po ashtu, nga viti 2015 ishin bartur edhe 19 rekomandime (të pa zbatuara 4 dhe 15 tjerat ishin në zbatim e sipër). Gjendja e këtyre rekomandimeve në vitin 2017 ishte: 10 të zbatuara, 5 pjesërisht dhe 4 nuk janë zbatuar. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni Shtojcën II.

Çështja 19 - Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak dhe viti i mëhershëm

- E gjetura** Për shkak të menaxhimit të dobët të procesit dhe mungesës së një monitorimi formal për mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të AP, vetëm një pjesë e rekomandimeve të vitit të kaluar dhe atyre të bartura më herët janë zbatuar. Edhe pse është hartuar plani i veprimit, MASHT nuk kishte formuar ndonjë komision për të monitoruar zbatimin e tyre.
- Rreziku** Dobësitë e vazhdueshme të kontrolleve të menaxhmentit dhe kontrolleve tjera në sistemet financiare kyçe kanë rezultuar në keq klasifikim të shpenzimeve, dobësi në prokurim, mangësi në menaxhimin e pasurive.
- Rekomandimi 19** Ministri duhet të siguroj që është zbatuar plani i veprimit, i cili përcakton saktë afatet kohore për zbatimin e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.

5 Qeverisja e mirë

Hyrje

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Në fazën e ndërmjetme të auditimit kemi dhënë disa këshilla për përmirësim përmes memorandumit të auditimit. Ne vlerësojmë angazhimin e MASHT-it i cili kishte adresuar disa çështje të ngritura në memorandumin tonë si - zbatimi i këshillës lidhur me pranimin e mallrave duke formuar komisione dhe hartuar procesverbale të shkruara. Po ashtu, ishte zbatuar edhe këshilla e dhënë për çertifikimin e bërë nga zyrtari çertifikues pa specifikacion teknik ishte adresuar.

Përkundër kësaj ende ekzistojnë dobësi në fushat të ndryshme të qeverisjes.

Mungesa e zbatimit të plotë të rekomandimeve ka ndikuar, në qeverisje dhe në vlerë të dobët për parane. Në raportet e auditimit për PFV e vitit 2013 dhe 2014 Zyra e Auditorit të Përgjithshëm dy vite radhazi kishte rekomanduar që të rishikohet memorandumi i mirëkuptimit i nënshkruar në mes të MASHT-it, Loyola-Gymnasium dhe Komunës së Prizrenit. Me atë memorandum MASHT kishte për obligim të paguaj për çdo vit pagat për anëtarët e stafit të gjimnazit Loyola sipas nivelit të shkollave publike. Një rishikim i këtij memorandumi nuk kishte ndodhur dhe si rezultat i kësaj ministria në fund të vitit 2017 me vendim të qeverisë i kishte paguar 720,000€ nga kategoria e subvencioneve për vitet 2015/16/17 këtij gjimnazi. Vlen të theksohet se me 22.02.2018 Ministri e kishte shfuqizuar nenin 2 të memorandumit që parashihte obligimet financiare të MASHT.

Rekomandimi i dhënë nga ZAP në vitin 2015 që ndërlidhet me auditorin e brendshëm në UPz nuk ishte adresuar. Auditori i brendshëm në UPz vazhdon të paguhet pa kryer asnjë raport të auditimit.

Më tutje, MASHT në hartimin e legjislacionit sekondar nuk i kishte kushtuar rëndësi harmonizimit me ligjet primare. Si rezultat i kësaj pakujdesie MASHT gjatë vitit 2017, ishte dëmtuar në aspektin financiar (për këtë çështje referoju gjetjes të detyrimit kontingjente). Mos konsistenca e rregulloreve

dhe udhëzimeve administrative me ligjet ishte prezantuar si gjetje në raportet tona të vitit të më hershëm, si në raportin vjetor të auditimit po ashtu edhe në raportet për ministrin. Edhe pse ishte rekomanduar, MASHT nuk kishte ndërmarr ndonjë veprim konkret për të inicuar rishikimin e Ligjit nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe legjislacionit tjetër sekondar.

Komiteti i auditimit edhe pse është i themeluar dhe kishte mbajtur tre takime nuk ishte efektiv për t'i trajtuar te menaxhmenti raportet e auditimit të brendshëm.

5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me dy anëtarë të stafit - Drejtori i NjAB dhe një auditor. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës që reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të entitetit të audituar dhe që ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i produkteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja e ofruar nga një Komitet efektiv i Auditimit.

Në planin vjetor të auditimit për vitin 2017, NjAB kishte planifikuar që të kryej nëntë auditime, dhe nga ky planifikim kishte arritur që t'i përfundonte gjashtë si dhe kishte kryer edhe dy auditime me kërkesës të menaxhmentit. Aktivitetet audituese kishin mbuluar kryesisht vitin 2016 (në pesë raporte të përfunduara) dhe se kjo ka ndikuar që menaxhmenti në kohën e duhur të mos ketë një pasqyrë të qartë mbi nivelin e sigurisë dhe funksionimit të kontrollit të brendshëm. Auditimi i Departamentit për buxhet dhe financa, Qendrës së Studenteve dhe i Institutit të Historisë kanë mbetur të pa kryera.

Ne nuk jemi mbështetur në punën e NjAB-it për faktin se objektivat tona nuk ishin të njëjta me ato të NjAB-it, dhe pesë raporte të auditimit kishin fokus vitin 2016.

Çështja 20- Funkcionimi i dobët i NjAB

E gjetura

Ekzistojnë një numër dobësish që ndërlidhen me punën e NjAB-së, si:

- Rishikimet e auditimit të brendshëm nuk kanë trajtuar projekte për investime kapitale në vitin aktual, po ashtu planifikimi i auditimit të Qendrës së Studentëve është viti i dytë që nuk kryhet;
- Nga tetë raportet e përfunduara, vetëm në tre prej tyre ishte fokusuar në vitin 2017;
- Planet e veprimit nuk ishin përgatitur nga njësitë që ishin audituar nga auditimi i brendshëm; dhe
- Komiteti i Auditimit kishte mbajtur tre takime të rregullta por nuk kishte hartuar raport përfundimtar lidhur me konkluzionet e përgjithshme për raportet e auditimit të brendshëm.

Këto rezultate pasqyrojnë mungesën e vetëdijes së Menaxhmentit në njohjen dhe maksimizimin e përfitimit të auditimit të brendshëm ose për të kërkuar siguri për funksionimin efektiv të kontrolleve të brendshme. Kjo gjithashtu tregon cilësi të dobët të planifikimit të auditimit të brendshëm.

Rreziku

Auditimi i brendshëm nuk kishte ofruar sigurinë e duhur mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme. Mungesa e kontributit të pritur nga NJAB rritë rrezikun që sistemi i kontrollit të brendshëm të mos përmirësohet.

Rekomandimi 20

Për të arritur përfitimin maksimal nga aktiviteti i auditimit të brendshëm, Ministri duhet të sigurojë se Plani i NJAB mbështetet në fushat me rrezik dhe ndihmon aktivitetet operative në vazhdim. Komiteti i Auditimit duhet t'i rishikoj rezultatet e auditimit të brendshëm dhe veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e auditimit të brendshëm.

5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti i MASHT ka dizajnuar sisteme të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar, përfshirë strukturën organizative dhe linjat e llogaridhënies. Sekretari i Përgjithshëm mban takime të rregullta javore me Drejtor të Departamenteve. Për këto takime përgatiten procesverbale ku pasqyrohen aktivitetet e ndryshme operative, por se këto procesverbale (raporte) nuk janë të detajizuara dhe si rezultat i kësaj për qëllime të auditimit ne nuk jemi mbështetur në kontrolle.

Çështja 21 - Dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut

E gjetura Planifikimi i dobët i buxhetit, vonesa në pagesat e obligimeve, mos raportimi i plotë i detyrimeve kontingjente në mënyrën e duhur nga ana e menaxhmentit, mos realizimi i disa prej projekteve kapitale gjatë vitit edhe pse me buxhetin fillestar ishin planifikuar, ekzekutimi i pagesave përmes vendimeve gjyqësore dhe nga Thesari, janë rezultat i mungesës së kontrolleve efektive menaxheriale.

Në vitin 2017, Universiteti i Prizrenit⁶, Universiteti i Gjilanit dhe Universiteti i Ferizajt nuk kishin hartuar plane strategjike.

Rreziku Kërkesat e dobëta të llogaridhënies dhe raportimi financiar i cilësisë së ulët reduktojnë efektivitetin e menaxhimit financiar. Kjo rezulton me dobësi në procesin e buxhetit dhe e zvogëlon aftësinë e menaxhmentit për të reaguar ndaj sfidave financiare me kohë. Po ashtu, kjo ulë efektin e kontrolleve buxhetore dhe rrit rrezikun për shpenzime të parregullta. Rrjedhimisht, kjo mund të rezultojë edhe me ofrimin e shërbimeve jo cilësore.

Rekomandimi 21 Ministri duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, dhe plani i prokurimit duke përfshirë të gjitha programet e MASHT-it që kanë njësi të prokurimit duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e MASHT-it dhe menaxhmenteve respektive.

⁶ Upz 23.01.2018 kishte formuar komisioni për hartimin e planit strategjik tre vjeçar

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keq deklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keq deklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
Rekomandimi 1	Ministri duhet të analizojë arsyet për theksimin e çështjes dhe ti identifikoj veprimet që kërkohen për të mundësuar klasifikimin e duhur të shpenzimeve dhe prezantimin e drejtë në PFV.			Pa zbatuar
Rekomandimi 2	Ministri duhet të sigurojë që të zbatohet një çasje më serioze në trajtimin e rekomandimeve të AP nga niveli i menaxhmentit. Duhet siguruar se është zbatuar plani i veprimit, i rishikuar, i cili i përcakton saktë masat e ndërmarra, afatet kohore për implementim e rekomandimeve, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme. Plani i veprimit duhet të monitorohet formalisht në baza të rregullta dhe rezultatet e implementimit të rekomandimeve duhet të raportohen tek menaxhmenti për të ndërmarrë masat adekuate.		MASHT kishte hartuar planin e veprimit por ai plan nuk ishte monitoruar.	
Rekomandimi 4	Ministri duhet të analizojë arsyet përse pozitat kyçe nuk janë plotësuar me kohë me staf të rregullt. Më ministri duhet të prioritetizojë rekrutimin e stafit të rregullt në të gjitha pozitat që mbahen nga ushtrues detyre. Kjo rritë llogaridhënien, përgjegjësinë dhe siguron zhvillim efektiv të aktiviteteve të ministrisë.			Pa zbatuar

Rekomandimi 8	Për të arritur përfitimin maksimal nga auditimi i brendshëm, Ministri duhet të sigurojë funksionimin e Komitetit të Auditimit dhe maksimizimin e punës së Auditimit. Komiteti duhet të rishikojë në mënyrë kritike planet e auditimit të brendshëm (për të konfirmuar se ato bazohen në rrezik dhe t'i ofrojë sigurinë e kërkuar menaxhmentit) dhe rezultatet e auditimit të brendshëm. Gjithashtu duhet të rishikojë veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e auditimit të brendshëm.		Komiteti i auditimit ishte funksional duke i mbajtur tri takime gjatë vitit mirëpo nuk kishte bërë rishikimin e planeve të AB nëse ato bazohen në rrezik.	
Rekomandimi 10	Ministri duhet të sigurojë që performanca buxhetore të monitorohet në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim t'i identifikojë dhe adresojë barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar. Aty ku supozimet e buxhetit fillestar janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në procesin e rishikimit të buxhetit.		Si rezultat i planifikimit të dobët të buxhetit gjatë vitit ka pasur shumë përshtatje buxhetore.	
Rekomandimi 16	Ministri duhet të iniciojë një rishikim të gjendjes së borxheve, për të përcaktuar shkaqet e vonesave dhe masat e nevojshme për adresimin e tyre. Vlerësimi i detyrimeve duhet të vazhdohet të bëhet në baza të rregullta mujore dhe pagesat të bëhen në kuadër të limiteve kohore të përcaktuara me rregullat financiare			Pa zbatuar
Rekomandimi 19	Rektori i Universitetit të Prizrenit së bashku me Sekretarin e Përgjithshëm duhet të bëjnë një zgjidhje të menjëhershme për stafin e auditimit brendshëm dhe stafin e zyrtarit të pasurisë. Rektori para çfarëdo rekrutimi duhet të siguroj një dialog të shtuar me ministrinë për të sqaruar përgjegjësitë dhe të drejtat me qëllim të shmangies së keqkuptimeve të legjislacionit.			Pa zbatuar

Komponenta e auditimit	Rekomandimet e dhëna në vitin 2016	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
Rekomandimi 1	Ministri duhet të bëjë një rishikim gjithëpërfshirës për të analizuar arsyet e theksimit të çështjes si regjistrimin e librave, regjistrimin e shkollave dhe keq klasifikimin.		Ka bërë përpjekje që keq klasifikimet e shpenzimeve t'i evitoj duke i kontaktuar me Ministrinë e Financave por nuk kishte arritur që të zgjidh këtë çështje. Edhe këtë vit ka probleme me regjistrimin e pasurisë dhe keq klasifikimin.	
Rekomandimi 2	Plani i veprimit duhet të rishikohet dhe mbikëqyrja e zbatimit të bëhet në vazhdimësi.			Pa zbatuar
Rekomandimi 3	Pyetësori i vetëvlerësimit të plotësohet dhe Universitetet publike të hartojnë strategjitë e tyre.		Disa Universitete kanë hartuar strategji, disa ende jo.	
Rekomandimi 4	Pozita me ushtrues detyre brenda një periudhe të arsyeshme të plotësohen me staf të rregullt.			Pa zbatuar
Rekomandimi 5	Komiteti i auditimit të jetë më aktiv në monitorimin e NJAB-it.			Pa zbatuar
Rekomandimi 6	Klasifikimi i shpenzimeve të bëhet në pajtim me planin kontabël.			Pa zbatuar
Rekomandimi 7	Dhënie e avanceve në pajtueshmëri ligjore.	I zbatuar		
-Rekomandimi 8	Pagat dhe kompensimet të bëhen në pajtim me rregullores me të ardhura personale dhe kontrollet e vijueshmërisë të forcohen.	I zbatuar		
Rekomandimi 9	Unifikimi i rregulloreve për të ardhura personale për kompensim të mësimdhënësve për provime.			Pa zbatuar
Rekomandimi 10	Vazhdimi i kontratave publike kornizë.	I zbatuar		

Rekomandimi 11	Mbikëqyrja e projekteve kapitale	I zbatuar		
Rekomandimi 12	Vonesa në realizim të projekteve			Pa zbatuar
Rekomandimi 13	Menaxheri i kontratës	I zbatuar		
Rekomandimi 14	Planifikimi i prokurimit të përfshijnë kohën e përafërt të realizimit të prokurimeve.	I zbatuar		
Rekomandimi 15	Procedimi i pagesave të bëhet sipas bazuar në procesin e rregulluar me rregulla financiare për ekzekutim të pagesave.			Pa zbatuar
Rekomandimi 16	Mbyllja e Avanceve me kohë	I zbatuar		
Rekomandimi 17	Te formohet komisioni i pranimit të mallrave.	I zbatuar		
Rekomandimi 18	Harmonizimi i bazës ligjore - UA për tekste shkollore			Pa zbatuar
Rekomandimi 19	Shpërndarja e teksteve shkollore.	I zbatuar		
Rekomandimi 20	Menaxhimi i dobët i regjistrave të pasurive.		Një pjesë të konsiderueshme të pasurisë e kishte transferuar te komunat përkatëse, mirëpo gjatë vitit 2017 ende ka pasuri që duhet të transferohen te komunat.	
Rekomandimi 21	Menaxhimi i obligimeve.			Pa zbatuar

Shtojca III: Komentet e ministrit në gjetjet e raportit të auditimit

Të gjeturat/ çështjet	Pajtohemi po/jo	Komentet e OB-së në rast të mospajtit ⁷	Pikëpamjet e ZKA-së
Çështja 4 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Po/Jo	<p>MASHT ka planifikuar mire buxhetin por gjate shfrytëzimit te buxhetit janë paraqitur kërkesat për lëvizje te buxhetit neper kode ekonomike pese shifrore dhe neper kategori te ndryshme ekonomike. Këto ndryshime janë bere duke u bazuar ne ligjin e buxhetit te vitit 2017 te Neni 16 Transferi i shumave të ndara buxhetore ku i lejohet MASHT-it te transferoj buxhetin ne përqindje prej 15% me aprovim te Ministrisë se Financave ku Ministria te gjitha transferet e cekura me larte i ka bere ne baze te ligjit ne fuqi.</p> <p>Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë rekomandimet e auditorit i ka marrë me shumë përgjegjësi dhe prioritet që të realizohen. MASHT-i me qëllim të implementimit të rekomandimeve të auditorit gjatë proceseve të planifikimit të buxhetit ka kërkuar që shpenzimet për blerjen e librave dhe blerjen e inventarit të transferohen nga shpenzimet kapitale në kategoritë ekonomike mallra dhe shërbime. Kërkesat janë paraqitur në Ministri te Financave gjatë planifikimit të buxhetit 2017, me rastin e Qarkoreve buxhetore 2018/01 dhe, Rishikimin e buxhetit 2017 dhe planifikimeve buxhetore për vitin 2018. Përkundër kërkesave të vazhdueshme të MASHT-it që çështjet e buxhetit për blerjen e librave dhe blerjen e inventarit të rregullohen, ato nuk janë aprovuar, miratuar nga Ministria e Financave, kështu shpenzimet për blerjen e librave dhe blerjen e inventari ka vazhduar të bëhet nga kategoria e shpenzimeve kapitale. Ne planifikimin e buxhetit te vitit 2019 Ministria e Financave ka realizuar kërkesën e MASHT - it ME KASH 2019 - 2021 ku buxhetin për blerjen e librave e ka bartur ne kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime.</p>	<p>Sikur të bëhej një planifikim i mirëfilltë ndoshta nuk do të kishte nevojë të ketë aq shumë përshtatje nëpër kategori ekonomike gjatë vitit. Përkundër se kishte shumë përshtatje të buxhetit gjatë vitit 2017 ju vetëm 81% të buxhetit për mallra dhe shërbime keni arritur ta shpenzoni po ashtu vetëm 72% e buxhetit për shërbime komunale është shpenzuar. Po ashtu, vendosja e disa projekteve që për nga natyra janë mallrave dhe shërbime dhe subvencione në tabelat e investimeve kapitale tregon për një planifikim jo të mirë. Planifikimi jo i mirë i buxhetit ka ndikuar që MASHT të bëjë keqklasifikim të shpenzimeve me që rast opinionimi i auditimit është me theksim edhe për këtë çështje. Prandaj e gjetura jonë mbetet e pandryshuar në raport.</p>

⁷ Për shkak të korrektësisë në rastet ku nuk është pajtuar ministri ne i kemi vendosur komentet ashtu siç i kemi pranuar pa bërë ndonjë korrektim në drejtshkrim.

Çështja 8 Mos nënshkrimi i deklaratës së disponuesh mëri së fondeve nga ZKA dhe ZKF:	Jo	Kërkesa për zotim ka qenë me 25.01.2017, kurse nënshkrime për disponueshmërinë e mjeteve ka qenë të nënshkruara me 20.03.2017 (5,000 Euro). Njftimi për kontratë ka dalë gabimisht 9,900 Euro. Kontrata është 4,717Euro. Asnjë tender nuk mund të shpallet dhe pastaj të zgjidhet fituesi pa qen i nënshkruar formulari për disponueshmërinë e mjeteve.	Gjetjen ne e kemi bazuar në dokumentin e datës 13.11.2017 deklarata e disponueshmërisë së fondeve, ku në atë dokument shihet se Zyrtari Kryesor Financiar dhe Zyrtari Kryesor Administrativ nuk ishin nënshkruar. Edhe pse keni komentuar ju nuk keni ofruar asnjë dëshmi për çështjen e ngritur në raport. Prandaj e gjetura mbetet e pandryshuar.
Çështja 15 Tejkalimi i sasive të kontraktuara	Po/Jo	<p>Lidhur me “Ndërtimin e shkollës fillore Gllloboqicë-Kaçanik” Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjise me daten 22.05.2017 ka pranaur nga DKA e Kaçanikut kerkesen me numer protokoli 610/01-16686, per mbeshtetjen e nderyhyrjeve ne projektin per ndertimin e objektit te shkolles fillore ne Gllloboqicë.</p> <p>Pas pranimit te kerkeses, zyrtaret e MASHT divizioni i menagjimit te projekteve dhe objekteve shkollore ka vizituar punishten ku po ndertohet obejekti i ri dhe ne konsultim me drejtorine shkolles dhe ingjnieret e MASHT jemi pajtuar me kerkesen tuaja dhe kemi vleresuar si te drejt.</p> <p>MASHT ka shikuar mundesit e sigurimit shtese te mjeteve financiare per te plotesuar ndryhsimet ne projekt te cilat kerkojnë rritjen e siperfaqes se objektit rreth 100m².</p> <p>Si p.sh ngritja e sasive te: Germimi, armimi, betonimi, muratimi, suvatimi, elektrika si dhe pozicionet tjera per funksionalizimin e objektit te shkolles ne fjale.</p> <p>-Andaj, bazuar në nenet e 61.20 RrUOPP të ligjit nr. 04/1-042 për prokurimin publik të republikës së kosovës,i ndryshuar dhe plotësuar me lgjin nr. 04/1-237, ligjin nr. 05/1-068 dhe ligjin nr. 05/1-092 ndryshimi i ndonjë pozicioni të kontratës në implementim, mund të bëhet, mirëpo pa e ndryshuar çmimin total te kontratës .</p>	Dëshmitë e ofruar nga ju ne i kemi pasur në shqyrtim deri sa ishim në teren, të cilat i kemi analizuar. Ju keni rrit sasi të gjatë realizimit duke tejkualuar sasi të e kontraktuara dhe nuk keni ndryshuar kontratën ashtu siç parashihet me neni 61.22 Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik. Prandaj e gjetura jonë mbetet e pandryshuar.

		<p>-Sipas nenit 61.24 Sa i përket sasive shtesë të artikujve të njëjtë janë përdorur çmimet më të ulta ,</p> <p>Ne si zyre sipas nenit 61.24 të rregullores kemi respektuar Ligjin dhe rregulloret në fuqi kemi marrur aprovim shtes nga nga Zyrtari Kryesor Administrativ.</p>	
Çështja 17 Rritja e obligimeve dhe raportimi i drejt i obligimeve të papaguara	Jo	<p>Rritja e obligimeve të pa paguara ka ndikuar vendimi i Qeverisë për reduktimet të fondeve të alokuara në bazë të vendimit me numër 08/151 të datës 02.08.2017 ku MASHT ka qenë i dëmtuar në shkurtime buxhetore në vlerë prej 2,923,433.23 dhe me rishikim të buxhetit prap ka pasur shkurtime të buxhetit nga kategoria ekonomike e shpenzimeve kapitale ku krahasimi mes buxhetit të aprovuar 16,986,920.00 € dhe atij final është 12,066,460.75€. Shkurtime buxhetore në shpenzime kapitale janë në vlerë prej 4,920,459.25 dhe këtu vërehet se shkurtime kanë ndikuar në rritjen e obligimeve të papaguara ku prej obligimeve në vlerë prej 948,433.77. Nga këto obligime pjesën më të madhe e bëjnë shpenzimet kapitale në vlerë prej 409,685.20 ku shifet se rritja e obligimeve ka ndikuar shkurtime të buxhetit në vitin 2017 e jo si është cek me lartë nga mos menaxhimi i mirë i obligimeve. Gjatë vitit 2017 në vazhdimësi është kërkuar nga programet dhe Departamentet e MASHT-it që të raportojnë faturat (obligime) e papaguara. Raportimi i faturave (obligimeve) në Departamentin e Thesarit është bërë në bazë të Rregullës Financiare të Thesarit Nr. 04/2011 dhe janë dërguar raportet në Departament të Thesarit.</p>	<p>Është i pakuptimtë fakti që ju arsyetoheni për mungesë të fondeve kur në fund vitit 2017 keni shpenzuar vetëm 81% respektivisht 72% të buxhetit për mallra dhe shërbime dhe komunalit përderisa obligimet e papaguara për këto kategori keni raportuar 521,640€. Në mungesë të ofrimit të dëshmitave, e gjetura mbetet e pandryshuar për faktin se obligimet nuk ishin menaxhuar siç duhet. Fakti që keni raportuar obligime edhe disa fatura të vitit 2018 në obligimet e vitit 2017 më së miri tregon që ju nuk keni kontrollin e duhur në proces të menaxhimit të tyre. Po ashtu një menaxhim i dobët konsiderohet kur ju nuk kishit raportuar 8,480€ obligime në PFV e 2016 ndërsa i keni raportuar në PFV-të e 2017.</p>
Çështja 20 Funksionimi i dobët i NJAB	Jo	<p>Qendra e studentëve në planin vjetor të auditimit ishte në muajin tetor-nëntor e planifikuar mirëpo me dt 21.09.2017 kemi pasur kërkesë për auditime të jashtëzakonshme në Administratë nga Ministri i MASHT-it dhe për këtë arsye Qendra e Studentëve është audituar në janar të 2018-tës. Të bashkangjitur keni shkresën zyrtare nga Kabineti i Ministrit.</p>	<p>Është vetëm arsyetim pa ofruar asnjë dëshmi. Fushat me rrezik të lartë duhen të jenë prioritet i auditimit të brendshëm. Qendra e studentëve as në 2016 dhe as në 2017 nuk është audituar nga njësia juaj. E gjetura mbetet e pandryshuar.</p>

		<p>Ne si Njësi e auditimit fillojmë auditimet nga Janari i vitit aktual dhe në ato auditimet e para nuk mundemi me auditu periudhën aktuale pasi që është fillimi i vitit dhe nuk mund të auditohet java e parë e janarit apo edhe auditime një mujore apo dy mujore. Praktikë e jona është që të auditojmë tre mujorin-gjashtë mujorin, edhe nëntë mujorin apo edhe komplet vitin janar-dhjetor për auditimet në fund vit. Andaj nëse keni një rekomandim se si të auditohet aktualiteti për muajtë e parë të vitit Ju lutem të na jeni sygjerime shtesë dhe ne do ti përmbahemi rekomandimeve tuaja.</p> <p>Të gjitha planet e veprimit u janë bashkangjitur për secilin entitet të audituar. Do tua bashkangjesim edhe si kopje fizike si dëshmi.</p> <p>Komiteti i Auditimit kishte hartuar raport përfundimtar lidhur me konkluzionet e përgjithshme për raportet e auditimit të brendshëm shih raportin i dt 20.01.2012 raport i dorëzuar tek ju gjatë fazës së auditimit në MASHT. Do tiu bashkangjesim edhe këtë edhe njëherë.</p>	<p>Puna e kësaj njësie kryesisht ishte e fokusuar në auditimitn e aktiviteteve për vitin 2016, ndërsa fokusi është dashtë të jetë viti 2017 ashtu siç është përshkruar në gjetje.</p> <p>Ne ju kemi jap rekomandimet e nevojshme se çka duhet bërë, ndërsa nëse ju nuk e keni të qartë dhe ju duhen trajnime atëherë drejtohuni Njësisë Qendrore Harmonizuese.</p> <p>Në raportet që keni ofruar në kohën sa ne ishim në auditim nuk kanë qenë të bashkangjitura planet e veprimit të plotësuar nga njësit e audituara, sidoqoftë edhe pse ju tani i keni sjell disa plane, për ne, ato nuk janë relevante për shkak se të gjitha planet e veprimit të ofruara tani nga ju janë të muajit janar 2018 edhe për raportet që ishin kryer në gjysmën e vitit 2017.</p> <p>Lidhur me Komitetin e Auditimit ju na keni ofruar një raport vjetor të komitetit të auditimit me vonesë me 23.03.2018 pas përfundimit të punës në teren dhe i pa nënshkruar. Për më shumë ky raport përmend raportet e auditimit të kryera për 2016 e jo të gjitha raporte e vitit 2017. Kështu që e gjetura jonë mbetet e pandryshuar.</p>
--	--	--	---

Çështja 21 Dobësit në kontrollet menaxherial e dhe menaxhimin e rrezikut	Jo	Problemi kyç gjatë shpenzimit të buxhetit në vitin 2017 ka qenë obligimi i vënë për herë të parë nga MEF që plani dhe ekzekutimi i buxhetit të bëhet edhe për nënkode ekonomike. Mungesa në plan e vetëm një euroje e ka pamundësuar pagesën e obligimeve sepse duhej procedurë e gjatë për paraqitjen e kërkesave për t'i batur fondet nga një nënkod në tjetrin. Kjo, sidomos në fund të vitit buxhetor, që ka shkaktuar që të mbesin mjaft obligime të papaguara në një anë e në anën tjetër të ketë tepricë buxheti. Planifikimi i buxhetit strikt për 12 muaj dhe për mbi 50 pozicione (nënkode) është i pamundur të bëhet. Kjo, fatmirësisht, është mënjanuar në vitin 2018.	Është vetëm një arsyetim i bërë pa ofruar dëshmi, ne ju kemi jap përgjigjen te çështja 4 dhe 17. E gjetura mbetet e pandryshuar.
--	----	--	--

Shtojca IV: Letër konfirmimi



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - Ministarstva za Obrazovanje
Nauku i Tehnologiju - Ministry of Education, Science and Technology*

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2017 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017.
- Komentet lidhur me të gjeturat e adresuara i gjeni në shkresën zyrtare me nr.referencës 2125 i dt . 15.05.2018
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.


z. Shyqiri Bytyqi

Ministër - Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë,

Data:15.05.2018, Prishtinë